

# PER KUFIRIN TONE DETAR FLASIN EDHE “PERENDITE”


ILIR MATI

Kriza e furnizimit të Europës me gazin rus, gjatë viteve 2007 dhe 2009, për shkak të paqëndrueshmërisë qeverisëse në Ukrainë, bëri që të interesuarit, Rusia, e në veçanti Gjermania dhe Europa e Bashkuar, të marrin masa edhe për shmangien e kalimit të tubave nëpër Ukrainë. Për këtë, lindën tre projekte gazsjellësish: Projekti i Linjës së Veriut, Linja e Jugut dhe Linja Nabuko, edhe kjo e fundit po nga jugu.

**Linja e Veriut**, projekt i mbrojtur nga Gerhard Schroder, parashikohet të përfundojë në vitin 2012. Ajo ka kapacitet për transportimin e 55 miliardë metrave kub gaz, është e gjatë 1200 kilometra dhe kushton 7.4 miliardë euro. Pjesëtar në këtë aferë janë: Gazprom me 51%, BASF Wintershall (All) 20%, EON (All) 20%, Gasunie (Vendet e Ulëta) 9%. Punimet e kësaj linje kanë gjetur pengesa nga Finlanda dhe Suedia. Deri tani, nga kjo vonesë, Gazprom llogarit 2 miliardë euro humbje, ndërkohë që projekti është 7.4 milionë. Gazprom ka “vënë” në punë Kryeministrin Putin për t’u marrë vesh me vendet nordike.

Më 20 tetor, Danimarka i dha dritë jeshile kalimit të gazsjellësit në ujërat e saj. Më 25 tetor, në Peterburg, Kryeministri i Finlandës, Matti Vanhanen, i komunikoi Kryeministrin Putin se qeveria e tij, në ditët e para të nëntorit, do të marrë një vendim në lidhje me kalimin e Linjës së Veriut nëpër ujërat e zonës së saj ekonomike. “Pas kësaj, - shtoi ai, - shërbimet e ngarkuara me ekologjinë do të japin autorizimin e punimeve. Mendojmë se kjo do të bëhet para fundit të vitit”.

Vështirësia më e madhe për projektin ka hasur te Suedia, e cila deri në fund të këtij viti, kryeson Europën e Bashkuar. Ministria e Mjedisit e Suedisë, e drejtuar nga Andreas Carlgren, nuk ka dhënë ndonjë datë për përgjigje ndaj kësaj çështjeje. Suedia thotë se çështja e Projektit Linja e Veriut është procedurale. Konsorciumi, që merret me këtë projekt, ka mundësi të marrë leje nga Suedia, vetëm nëse ai do të garantojë ruajtjen e mjedisit në bazë të ligjeve “shumë ekzigjente” të Suedisë për



mjedisin dhe zbatimin e së drejtës ndërkombëtare. Përfaqësuesi i Projektit Linja e Veriut në Suedi, Lars Gronsted, ka thënë se “janë të kënaqur për këtë, sepse konsorciumi i ka plotësuar të gjitha kërkesat”. Gjithsesi, në portin suedez Karskrona, janë stokuar 4 mijë tuba me gjatësi 12 metra secili.

Në Suedi, ndërtimi i gazsjellësit ka sjellë zemërim, për shkak se Deti Baltik është bërë një nga detet më të ndotur të botës. Kujdesi i Suedisë, për sa i takon ndërtimit të gazsjellësit, lidhet edhe me sigurinë e vendit nga prania e marinës ruse në zonë. Në Suedi mendojnë se ndaj këtij gazsjellësi duhet të merret një

qëndrim politik. **Linja Nabuko**, projekt i mbrojtur nga Joscha Fischer, parashikohet të përfundojë në vitin 2014. Kapaciteti 31 miliardë metra kub. Gjatësia 3300 kilometra dhe kushton 7.9 miliardë euro. Ndërkohë, vonesave të Suedisë, Rusia i përgjigjet me bashkëpunimin e saj me

Italinë. Kryeministri Putin dhe Berlusconi luajnë kartën e Linjës së Jugut, e cila i kundërvihet Linjës Nabuko të Europës së Bashkuar.

“Projekti i Linjës së Jugut i ka të gjitha shanset të kryhet para Linjës së Veriut”, - tha në Peterburg Kryeministri Putin, gjatë takimit të tij, javën e shkuar, me Kryeministrin Berlusconi.

**Linja e Jugut**, projekt i mbrojtur nga Silvia Berlusconi, parashikohet të përfundojë në vitin 2013. Kapaciteti 63 miliardë metra kub gaz. 900 kilometra nën Detin e Zi, kushton 19 deri 24 miliardë euro. Kapitalet: 50% Gazprom, 50% ENI (Itali). Marrëveshja është nënshkruar nga vendet ku kalon gazsjellësi.

Siç duket edhe nga figura, gazsjellësi Linja e Jugut ka anashkaluar rrugën e tij më të shkurtër nëpër Maqedoni dhe Shqipëri, ashtu si gazsjellës të tjerë kanë anashkaluar Ukrainën problematike. Gjithsesi, tubi kalon në zonën detare ekonomike të Shqipërisë.

Rrugët nëpër det të gazsjellësve bëhen çështje të ndjeshme politike dhe ekonomike. Ato vënë në lëvizje, kompani, kapitale, politikanë, por edhe opinionin publik, sepse ndërtimi i tyre ka të bëjë edhe me fatin e jetës së tyre, të fëmijëve dhe nipërve të tyre.

Këto ditë, çështje të detit nuk diskutohen vetëm në Shqipëri, por edhe në Rusi, Gjermani, Danimarkë, Suedi, Finlandë.

A bëhet kufiri detar Shqipëri-Greqi pengesë për kalimin e gazsjellësit Linja e Jugut?

A ka lidhje nxjerrja në dritë e çështjes së rregullimit të kufijve detarë midis Shqipërisë dhe Greqisë, me projektin Linja e Jugut?

A ka nënshkruar Gazprom dhe ENI marrëveshje me Shqipërinë? Nëse po, a do t’i bëjë publike këto marrëveshje qeveria shqiptare?

“O Zot, për kufirin detar mes Shqipërisë dhe Greqisë flasin edhe ‘perënditë’ e kapitalit. Për mirë e për keq? Mjerë apo lum ne”.

**Shënim.** Ky shkrim ka marrë shkas dhe komenton artikullin e Alexandrinne Boulihet dhe Sebastien Buffet në gazetën franceze “Figaro”, datë 26 tetor 2009

# Dilema mes parimeve dhe pragmatizmit

IGLI TASHI\*

T’i qëndrojmë larg retorikës nacionaliste! Ky është një kusht paraprak që, çdo shkrim mbi çështjen e Kanalit të Otrantos (e thënë butë) apo dhurimit të një copëze Shqipërie (e thënë ashtu vendë), duhet të plotësohet, për të mos rënë pre e skemave akuzuese për ata, që në parim janë kundër paktit Shqipëri-Greqi për kufijtë detarë. Atëherë për të mos rënë në kurthin e nacionalizmit, i diabolizuar sikur të ishte një sëmundje e keqe, le të flasim për “kombëtarizëm”. Për këtë kemi të drejtë, apo jo?! Natyrisht që po. Por le të hyjmë në temë.

Në cilësinë e ministrit të Jashtëm, zv.kryeministri, Ilir Meta, deklaroi se marrëveshja me fqinj tonë, teknikisht është e drejtë. Megjithatë, e rëndësishme është që sot mund të themi me plot gojë, se një copëz Shqipërie nuk është më e jona! Kartonët e “liderit”, së bashku me ato të “baballarëve të kombit”, do ta bëjnë këtë, në një datë ende të pacaktuar. Në emër të kujt? Në emër të stabilitetit në rajon? Të rolit të “nxënësit të mirë”, që Shqipëria ka mbajtur dhe po mban më të gjithë (si ata që e respektojnë, ashtu dhe me ata që e fyejnë), pa një analizë të mirëfilltë kostopërfitim? Në emër të integritimit europian, këtij ylli polar (përcaktim që Kryeministri Berisha i bëri integritimit pak ditë pas aleancës paszgjedhore me LSI-në) pa të cilin as frymë nuk marrim dot dhe as jeta nuk paska më kuptim?

Një parantezë. Ç’do të thotë integritet? Është një koncept paksa flu dhe shumë i debatuar në

literaturë. Specialistët e ministrive përkatëse do të mundin me siguri të na e shtjellojnë. Por para se të na shpjegojnë këtë, u duhet të falin një copëz Shqipërie ...

Kam njohur dikur një person, për të cilin marrja e letrave në një shtet të huaj përëndimor u bë një objektivi aq i rëndësishëm, sa gjithçka sillej rreth saj. Këtë ai e konsideronte si fundin e vuajtjeve të tij. Aq objektivi i rëndësishëm u bë për të kjo gjë, sa i kushtoi tërë energjitë e tij... në një pikë të tillë sa luste Zotin të sëmurej, që të paktën për arsye humanitare, t’ia jepnin ato të shkreta letra. Dhe më të vërtetë u sëmure, me një sëmundje që i mori

*Nëse këtë marrëveshje do ta shikonim si të keqe, e mira të paktën do jetë që, një copëz Shqipërie do të hyjë në Europë para Shqipërisë sonë, por ... nga një derë greke. Na i kishte thënë dhe Papulias, ky grek që ka pirë gji shqiptar, se rruga jonë për në Europë kalon nga Athina*

jetën. Letrat i mori, po fatkeqësisht nuk jetoi gjatë për t’i gëzuar ato.

Le t’i kthehemi tani problematikës sonë, marrëveshjes me një titull të komplikuar me “shelje dhe delimitacione”. Le të mos kemi frikë nga termat dhe ta themi hapur. Patëm frikë, u stepëm dhe zgjodhëm rrugën më të lehtë (për disa) për të përfutur sa më shumë nga monedha “integritet”, e vetmja sipas qeveritarëve tanë, që lejon blerje pa shumë probleme të mallit “pushtet”.

Specialistët ministrive përkatëse do ta kenë të vështirë të argumentojnë integritimin europian si një integritim vlerash (përkufizim i dhënë ky për Komunitetin Europian nga një numër i madh

specialistësh e politikanësh). Sepse në këtë rast, kemi të bëjmë me një integritim interesash të errëta lokaliste, e në rastin tonë, partiake. “Po çdo e mirë e ka një të keqe dhe çdo e keqe një të mirë”, thotë populli. Nëse këtë marrëveshje do ta shikonim si të keqe, e mira të paktën do jetë që, një copëz Shqipërie do të hyjë në Europë para Shqipërisë sonë, por ... nga një derë greke. Na i kishte thënë dhe Papulias, ky grek që ka pirë gji shqiptar, se rruga jonë për në Europë kalon nga Athina. Nuk e di a e besuam atëherë, po pa zhurëm e pa potere si në rastin e Maqedonisë, po vërtetohet gjithnjë e më shumë se paska qenë e vërtetë!

Pak a shumë, këtë tha edhe ministri ynë i Jashtëm, i cili së fundmi u emërua dhe si përgjegjës i integritimit tonë. Na tha që pakti me Greqinë, teknikisht, është sipas normave. Sipas cilave norma? Sepse ato norma të debatuar në ato konferenca e prononcime që unë kam dëgjuar, vijnë prej disa “nacionalistësh”, “kombëtaristësh”, “ksenofobistësh”, e ç’është më e bukura, prej disa “specialistësh”. E natyrisht, për të yshtrur akuzën e nacionalistit, nuk mund të jem i prirë t’u besoj.

Specialistët e ministrive, që marrin dhe rrogën për këtë punë, nuk i dëgjuam ndonjëherë të argumentuarin. Pamë vetëm zyrtarët, që pohoi pa argumentuar. E pra, ju jeni vënë në krye për

të na drejtuar, për të na thënë çfarë është e mirë për ne dhe çfarë jo. Nuk po marr mundimin ta bëj këtë pyetje, se e di që do të më kthejë një përgjigje standarde dhe shumë cinike (për të mos thënë frikacake dhe e pështirë), se “më e mira për popullin tonë, si një faktor paqeje dhe stabiliteti në Ballkan, do të ishte integrimi në bashkësinë e vlerave”. Po në cilën kuti bronzi hermetike të fusim parimet dhe etikën? Atëherë në emër të këtij morali, të kësaj etike dhe bashkësie vlerash, lërimi të tjerët të thonë mendimin e të japin gjykimin e tyre; lërimi t’ju thonë se kjo që bëtet ishte e pandershme dhe jo transparente; t’ju thonë që ishit të pazotë;

lërimi t’ju thonë që integrimi në bashkësinë e vlerave, për ju, nuk është një objektivi, po një karotë që ia keni lidhur në qafë këtij populli që të vrapojë për ta kapur deri sa të lodhet; lërimi t’ju thonë që, sa më shumë qeveritë tuaja do t’i referohen yllit polar të integritimit, aq më shumë ky popull duhet të shqetësohet për aftësinë tuaj të kufizuar në zgjidhjen e problemeve; lërimi t’ju kërkohet të jini të ndershëm; lërimi t’ju thonë se nuk është as parimore, as morale, as etike, që 71 veta të kenë të drejtën të shesin pasurinë e 5 milionë të tjerëve. Sepse ai det është deti i shqiptarëve.

Ndoshta teknikisht kjo marrëveshje mund të jetë dhe e drejtë, por mënyra se si po menaxhohet, me mungesë transparence dhe arrogancë, të bën të besosh se intriga ballkanike qenka integruar në Europë para vlerave, moralit dhe etikës.

\* Ekonomist i specializuar në çështjet e menaxhimit të sigurisë - Universiteti i Lozanes (Zvicër)